

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pistat e hetimit - Tritoli në banesën e mësuesit në Shkodër, autori u maskua si shpërndarës picash! Çfarë filmuan kamerat e sigurisë!
ADRESA	https://www.syri.net/kronike/916316/tritoli-ne-banesen-e-mesuesit-ne-shkoder-autori-u-maskua-si-shperndares-picash-cfare-filmuan-kamerat-e-sigurise/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 12:04:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 11:08:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f78a0c44acd1894bedb6d4cdb9b271e04c93086453dc31be2bfc3489266d1694
TEKSTI	692774c0b4bff90a80fb8f4c413832eecd751041402835d84609240235b20deb
PAMJA	d2d886461e53bf789a3fa8b1a9fe00144b37f3fc95e188e2c7376f58a3434588

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c78bae9ca668ae8a2f6170aae7e9540190d524eea82ca7a9147a01f98bfd4ce5
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	f fe3484a9a9000951d0319deb7eab25f99edd91b8ae32dfd23370158c045acee
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/c78bae9ca668ae8a2f6170aae7e9540190d524eea82ca7a9147a01f98bfd4ce5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px




IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbësën



Tritoli në banesën e mësuesit në Shkodër, autori u maskua si shpërndarës picash! Çfarë filmuan kamerat e sigurisë!

13:08, 13/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Të tjera detaje janë bërë publike nga shpërthimi me tritol mbrëmë me 12 shtator në qendër të Shkodrës.

Lënda plasëse në banesën e shtetasit Mehdi Bushati, shumë afër bashkisë Shkodër mendohet se është vendosur nga një person i cili më pas është larguar me motor.

Nga kamerat e sigurisë, autori i dyshuar, mendohet se ka lëvizur i vetëm dhe është maskuar një një picajol, duke mbajtur një skafandër në kokë dhe motorin e kishte përshtatur si ato që shpërndajnë pica.

Pas shpërthimit me tritol ku nuk pati të lënduar por vetëm dëme materiale, shtetasi Mehdi Bushati, me profesion mësues ka deklaruar se ai nuk ka asnjë dijeni lidhur me ngjarjen.

Mësuesi i cili ndodhej në shtëpi bashkë me bashkëshorten e tij kur ndodhi ngjarja sipas burimeve nuk është treguar aq bashkëpunues me policinë.

Hetimet

Lënda plasëse sipas hetimeve të deritanishme të grupit hetimor mund të lidhet me vëllain e mësuesit, shtetasin Gëzim Alias Naser Bushati i cili prej vitesh ndodhet në Gjermani dhe hera e fundit kur ishte në Shqipëri daton 2-3 vite më parë. Në katin e parë jeton mësuesi Mehdi Bushati ndërsa kati i dytë i ndërtesës i përket vëllait të tij.

Gëzim Bushati i cili e ka ndryshuar emrin në Naser sipas burimeve ka qenë i dënuar me burg, një herë me 5 vite dhe një herë tjetër me dy vite në Rumani dhe Gjermani.

Për shkak të problemeve që mund të ketë jashtë vendit, policia vendore e Shkodrës dyshon se lënda plasëse u hodh në banesën e tij me qëllim për t'i dhënë një mesazh kërcënues.

Po ashtu mendohet se autori i dyshuar është një person me pagesë i cili afrohet, hedh lëndën plasëse brenda oborrit dhe më pas largohet në drejtim të paditur pa lënë gjurmë.

më të lexuarat



Vjedhje makinash në Vlorë/ 2 të arrestuar, njëri tentoi të vidhte edhe një 'Jeep' në Orikum



Si arriti të fitonte lirinë Lulzim Caka në Shqipëri! Emri me të cilin jetonte në Greqi, çfarë u zbulua në vilën e tij luksoze



Aksident në Orikum, përplasen 2 makina



Shkodra tronditet nga një shpërthim afër godinës së bashkisë, panik mes banorëve



Lezhë/ I shpërtheu bombola e gazit në banesë, ndërron jetë në Itali Saimir Kola



Detaje të reja - Shpërthim në Shkodër, eksploziv në oborrin e banesës së 60-vjeçarit (EMRI)



Deri më tani grupi hetimor nuk e ka identifikuar ende autorin e maskuar ndërsa po punohet përmes kamerave të sigurisë.

Shpërthimi rreth orës 21:30 të mbrëmjes së djeshme në Shkodër ishte shumë i fuqishëm, teksa ka tronditur banorët në qendër të qytetit por edhe zona të tjera. Në të njëjtën kohë dhjetëra turistë që ndodheshin në zonën përreth qendrës janë frikësuar ndjeshëm.

Në momentin e ngjarjes, pak metra më tutje në sheshin para bashkisë Shkodër po zhvillohej një koncert me muzikë dhe lojëra për fëmijët dhe familjet shkodrane.

Policia vijon punën për ta zbardhur të plotë këtë ngjarje të rëndë.

[Lexo edhe: Detaje të reja - Shpërthim në Shkodër, eksploziv në oborrin e banesës së 60-vjeçarit \(EMRI\)](#)

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rrogozhinë, kërcënoi me kalla*hnikov 35-vjeçarin, arrestohet 26-vjeçari, në pranga dhe...



Sulmi me 35 plumba kallashi mbi makinën në Mat, mesazh i qartë për Akil Lleshin. Ja dyshimet




Vorë/ I la fishekun dhe letrën kërcënuese te porta kushëririt për t'i marrë 300 mijë euro, prangoset 56-vjeçari

Aksident në aksin Lushnje – Berat, 2 të plagosur rëndë! U përplasën 3 makina



E kërcënuan në sallën e gjyqit, e ëma e Santiago Malkos bën kallëzim në polici 'Më dëmtuan varrin e djalit...'



Prej 3 ditësh e zhdukur në Rrogozhinë, familjarët apelojnë për ndihmë për gjetjen e Saxhide Dishës

TË NGJASHME



VIDEO/ Sulmi me armë në Mat/ Gjendet i djegur 'Golf-i' i autorëve, dy kallashnikovë brenda



Të shtëna me armë në Mat/ Breshëri me mbi 30 plumba ndaj makinës së familjes që u kthye nga Italia



Aksident në aksin Kuçovë-Berat, përplasen dy automjete, raportohet për dy të plagosur



Detaje të reja - Shpërthim në Shkodër, eksploziv në oborrin e banesës së 60-vjeçarit (EMRI)



Shkodra tronditet nga një shpërthim afër godinës së bashkisë, panik mes banorëve



Greqi/ Gjendet tjetër sasi kokaine pranë vilës së Lul Cakës, sekuestrohen edhe 26.8 kg kokainë (VIDEO)



Aksident në Orikum, përplasen 2 makina

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendojnë se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net